



**Datë:** 18.07.2025

**Numër Protokolli:** 5039/2025

**A.nr.1005/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave**, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1027/2025, të datës 29.05.2025, të parashtruar nga ankuesi G.G, kundër organit të punësimit/Inspektorati Qendrorë i Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.07.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**Hedhet poshtë si e parakohshme** ankesa me numër A.nr.1005/2025, e datës 29.05.2025, e parashtruar nga ankuesi G.G

## A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, G.G (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 29.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 15.05.2025, lidhur me refuzimin e aplikacioni të punësimit, për procedurën e rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00017329, për dy (2) pozitat e punës “*Inspektor për marrëdhënie të punës*”- Divizioni për Inspektim në Rajonin e Gjilanit, në kuadër të Inspektoratit Qendrorë të Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati Qendrorë i Punës, ndërsa, ky i fundit, me datë 16.06.2025, ka dorëzuar përgjigjën në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)

nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati Qendrorë i Punës, me datë 21.03.2025, ka publikuar Njoftimin për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00017329, për dy (2) pozitat e punës “*Inspektor për marrëdhënie të punës*”- Divizioni për Inspektim në Rajonin e Gjilanit, me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi ka aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, mirëpo sipas Njoftimit të datës 15.05.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendrorë të Punës, rezulton se të njëjtit i është refuzuar aplikacioni i punësimit, me arsyetimin se nuk ka bashkangjitur dokumentacionin e kërkuar sipas pikës 5 të konkursit, lidhur me dëshmimin e përvojës së punës.

Andaj, kundër Njoftimit të datës 15.05.2025, lidhur me refuzimin e aplikacionit të punësimit, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshill, duke kërkuar rishqyrtimin e aplikacionit dhe vazhdimin tutje në procedurat e rekrutimit nëse rezulton se i ka plotësuar kriteret.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*

Referuar kuadrit ligjor përkatës si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi më datë 29.05.2025, kundër Njoftimit të datës 15.05.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendrorë të Punës, lidhur me refuzimin e aplikacionit, është e parakohshme, ngase sipas dispozitave përkatëse ligjore, kandidati për pranim në shërbim civil ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesi ka dorëzuar ankesën ende pa u publikuar rezultatet përfundimtare të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017329, për dy (2) pozitat e punës “*Inspektor për marrëdhënie të punës*”- Divizioni për Inspektim në Rajonin e Gjilanit, me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Andaj, theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e dorëzuar nga ankuesi me datë 29.05.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa u publikuar ende rezultatet përfundimtare lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është e parakohshme në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta është e papranueshme, kështu që, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin

18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të hedhë poshtë si të parakohshme ankesën A.nr.1005/2025, të datës 29.05.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1005/2025**

**Atdhe GASHI**

\_\_\_\_\_  
**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

\_\_\_\_\_  
**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit G.G;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendrorë të Punës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.